

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-211/15

**Prishtinë,
21 Shkurt 2018**

Në çështjen juridike të:

M. Š.

Pala ankuese

**Kundër
M. Rr.**

Palë përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA48961), të datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 21 Shkurt 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. Š. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014, të datës 18 Qershor 2014;
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014, i datës 18 Qershor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA48961.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 Nëntor 2007, M. Š. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore ku kërkon ri-posedimin e banesës e cila gjendet në lagjen *adresa ...*, në Prishtinë me sipërfaqe prej 63.31 metra katrorë. Pala ankuese ka theksuar se është pronar i banesës dhe se e njëjta është e uzurpuar nga M. Rr. dhe kërkon kthimin e posedimit dhe kompensimin e dëmit për shfrytëzim të pa autorizuar. Humbjen e posedimit e deklaroi në Qershor të vitit 1999.
2. Së bashku me kërkesën pala ankuese ka dorëzuar në AKP *inter alia*:
 - Kontratë shitblerje Ov. Nr. 1483/97 e datës 18 Mars 1997 me të cilën dëshmohej se banesa ishte blerë nga Ndërmarrja “EXIMKOS”, kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës;
 - Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Prishtinë P.Br. 1350/93 i datës 4 Dhjetor 1995 me të cilin shkëputej kontrata e shfrytëzimit me M. Rr. dhe i njëjti obligohej që ta liroi banesën nga njerëzit dhe sendet;
 - Vërtetim i lëshuar nga Ndërmarrja “EXIMKOS” me numër 0201/13 i datës 20 Dhjetor 1996 me të cilin konfirmohej se pala ankuese e kishte paguar shumën prej 2.212,11 dinarë në emër të çmimit blerës;
 - Aktvendim mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim numër 522 i datës 28 Dhjetor 1995 me të cilin Ndërmarrja “EXIMKOS” i ndante në shfrytëzim pronën e kërkuar palës ankuese;

- Kontratë shfrytëzimi e lidhur në mes të Ndërmarrjës publike banesore në Prishtinë dhe palës ankuese numër 1193/13544 e datës 6 Shkurt 1996 ;
 - Marrëveshje në mes të palës ankuese dhe Ndërmarrjes “EXIMKOS” nr 423 me të cilën pala ankuese heqë dore vullnetarisht nga banesa 40 metra katrorë e cila ndodhet në lagjen “Bregu i Diellit” dhe ja le në shfrytëzim Ndërmarrjës “EXIMKOS” kurse merr pronën e kërkuar në shfrytëzim.
 - Kontratë shitblerje Ov. Nr. 940/94 e datës 17 Qershor 1993 me të cilën dëshmohej se banesa në lagjen “Bregu i Diellit” ishte blerë nga bartesi is të drejtës së ndarjës, Ndërmarrja “EXIMKOS”, kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës;
 - Aktvendim mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim numër 2200 i datës 10 Qershor 1986 me të cilin Ndërmarrja “EXIMKOS” i ndante në shfrytëzim banesën 40 metra katrorë e cila ndodhet në lagjen “Bregu i Diellit” palës ankuese ;
 - Kontratë shfrytëzimi e lidhur në mes të Ndërmarrjës Publike Banesore në Prishtinë dhe palës ankuese numër 1193/12014 e datës 11 Gusht 1986 për shfrytëzim e banesës 40 metra katrorë e cila ndodhet në lagjen “Bregu i Diellit”;
 - Dëshmi të ndryshme për pagesën e shërbimeve të komunalive që dëshmojnë për shfrytëzimin e pronës së kërkuar para vitit 1999.
3. Identifikim i kërkesës ishte bërë më 7 Shkurt 2008 dhe kohën e vizitës prona ishte gjetur në shfrytëzim si banesë por banuesi aktual nuk kishte qenë prezent..
 4. Më 7 Tetor 2008, M. Rr. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ishte paraqitur në AKP dhe kishte theksuar se prona e kërkuar është vendosur me Vendim të Organit kompetent dhe se ai është pronar i kësaj prone:
 5. Për të mbështetur kërkesën pala përgjegjëse ka dorëzuar në AKP *inter alia*:
 - Aktvendimin mbi ndarjen e banesës numër 02-4-4 të datës 29 Dhjetor 1983 me të cilin Ndërmarrja “EXIMKOS” i ndante në shfrytëzim pronën e kërkuar;
 - Kontratë shfrytëzimi e lidhur në mes të Ndërmarrjës Publike Banesore në Prishtinë dhe palës përgjegjëse numër 1193/13544 e datës 31 Gusht 1987 për pronën e kërkuar;
 - Vendimi i Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore (KKPB), HPCC/REC/94/2007 i datës 26 Mars 2007 me të cilin Komisioni i Kërkesave Pronësore e Banesore urdheron që palës përgjegjëse në rastin konkret i aprovohet kërkesa DS00262 e kategorisë A dhe i kthehet e drejta pronësore e humbur si pasojë e diskriminimit kurse palës ankuese i njihet e drejta në kompensim nga Drejtorati;

6. Sipas raportit të verifikimit të datës 1 Prill 2011 dokumentat e paraqitura nga palët ishin gjetur dhe verifikuar pozitivisht. Kontrata e shitblerjës fizikisht nuk ishte gjetur por zyrtari i Gjykatës e kishte pohuar autenticitetit e nënshkrimit.
7. Më 18 Qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/A/247/2014 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetim të vendimit (paragrafet 20 dhe 47), KKPK-ja ka theksuar se provat e dorëzuara nga pala ankuese, të verifikuara nga Sekretaria Ekzekutive kanë treguar se çështja ishte vendosur me vendim të formës së prerë dhe bazuar në dispozitat e nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 KKPK-ja do ti hedhe kë'rjesat të cilat janë vendosur më parë.
8. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 13 Tetor 2014. Më 23 Tetor 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Më 17 Qershor 2015 i ishte lënë në derë ankesa palës përgjegjëse, megjithatë ajo nuk ka dërguar përgjigje në të.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së është i jashtëligjshëm dhe kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj ankesën dhe të “rivendos gjendjen që ka ekzistuar para konfliktit”, pasi që humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur për shkak të konfliktit të armatosur dhe se në kohën e konfliktit ai ka qenë pronar i banesës objekt i kësaj kërkesë.
10. Pala ankuese gjithashtu nuk pajtohet me konstatimin se KKPK-ja nuk ka juridiksion për çështjet të cilat janë vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë dhe se bazuar në provat e paraqitura pala ankuese del se është pronare e pa kontestuar e pronës së kërkuar. Ai pretendon se ka bërë kërkesë për njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe se kjo kërkesë nuk është e njëjte me të parën.
11. Pretendimet e palës ankuese janë se ai ka hyrë në marrëveshje me dhënësin e banesës ashtu që ka bërë ndërrim të banesës së mëparshme mbi të cilën ai kishte të drejtë pronësie dhe la marrë në shfrytëzim pronën e kërkuar të cilën sipas ligjeve në fuqi e ka blerë nga ndërmarrja shoqërore.

Pranueshmëria e ankesës

12. Gjykata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për Vendimin.

Arsyetimi ligjor

13. Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së ishte marr pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi një bazë të tillë si e drejta materiale ashtu edhe ajo procedurale janë zbatuar në mënyrën e duhur. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

14. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së mbështetet në nenin 8.6.c të urdhërese administrative nr. 2007/5 për implementimi i rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale të amandamentuara me Ligjin nr. 03/L-079, i cili thotë: Komisioni me vendim mund të *“refuzojë apo hedh poshtë kërkesën bazuar në çfarëdo arsye, përfshirë edhe ato të cekura në nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50”*. Rrjedhimisht, dispozita e nenit të cituar duhet të kuptohet se juridiksioni i KKPK-së -së përjashtohet nëse *“Kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë”*.

15. Ky vendim ishte marrë nga Komisioni i Kërkesave Pronësore dhe Banesore (KKPB) mbi bazën e nenit 1.2(a) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, ku përcaktohet juridiksioni ekskluziv për pranimin dhe vendosjen e këtyre kërkesave *“Paraqitësi i kërkesës i kategorisë A që pretendon humbjen e pronës si pasojë e diskriminimit dhe kërkon pronën mbi bazën diskriminimit duhet të dëshmoj të drejtën mbi pronën e paluajtshme dhe se pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore i është revokuar pas datës 23 Mars 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij”*. Pra prona i ishte kthyer palës konkurruese që e kishte

humbur mbi bazën e diskriminimit kurse pala ankuese në rastin konkret kishte të drejtë kompensimi adekuat sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

16. Bazuar në nenin 2.7 UNMIK/REG/1999/23 parasheh se: Vendimet përfundimtare të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore (KKPB) janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.
17. Në paragrafin 47 arsyetohet hedhja e pjesës së kërkesës për kompensim të dëmit material apo fitimit të humbur lidhur me pamundësinë e shfrytëzimit për shkak të mungesës së Juridiksionit të KKPK-së.
18. Nga të gjitha arsyet e përmendura më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafi 1(d) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Ragip Namani, Gjyqtar

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Bjorn Olof Brautigam , Referente e EULEX-it